



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



## Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok  
Municipal Assembly Istog

Komiteti për Politikë dhe Financa / Komitet za Politiku i Financije / Policy and Finance Committee

|                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                       |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 16                                                                                                                                                                                                 | <b>Procesverbal</b>                                                                                                                                                   |
| <b>Tipi i mbledhjes:</b>                                                                                                                                                                           | Mbledhje e rregullt e KPF-së                                                                                                                                          |
| <b>Data e mbajtjes:</b>                                                                                                                                                                            | 21.06.2019, në ora 10:00                                                                                                                                              |
| <b>Mbledhjen e kryesoi:</b>                                                                                                                                                                        | Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit                                                                                                                                      |
| <b>Procesmbajtës:</b>                                                                                                                                                                              | Arlinda Kurtaj, Udhëheqëse e Sektorit për Punë Administrative të KK-së, Punë të Përbashkëta dhe Cështje Teknike                                                       |
| <b>Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së</b>                                                                                                                                                               | Zenel Shatri, Besa Ferati, Haki Podrimaj, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Ardita Idrizaj                                                                                |
| <b>Mungojnë:</b>                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                       |
| <b>Pjesëmarrës të tjerë:</b>                                                                                                                                                                       | Nënkryetari Agim Ademaj, Edona Bujupi-Loxha, Lulzim Blakaj, Enver Rugova, Jashar Blakaj, Drin Sadikaj, Hysni Maxharri, Osman Sadikaj, Zekije Sutaj dhe Vjosa Hysenaj. |
| <b>Rendi i ditës:</b>                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                       |
| 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                       |
| 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020-2022,                                                                                                                                |                                                                                                                                                                       |
| 3. Shpallja në diskutim publik e Plotësim-ndryshimi Rregullores komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për subjektet afariste në komunën e Istogut,                                  |                                                                                                                                                                       |
| 4. Shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për transparencë dhe Plani i punës së veprimit dhe                                                                                            |                                                                                                                                                                       |
| 5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimeve të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme të komunës me prona private.                                                          |                                                                                                                                                                       |
| <b>Diskutimet:</b>                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                       |
| Kryesuesi z.Qaush Balaj, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje. |                                                                                                                                                                       |
| <b>Vendimet:</b>                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                       |
| Miratohet njëzëri rendi i ditës, pa ndryshime.                                                                                                                                                     |                                                                                                                                                                       |
| <b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>                                                                                                                                                             | Shërbimi për punë të kuvendit                                                                                                                                         |
| <b>Afati për zbatim:</b>                                                                                                                                                                           | Deri në mbledhjen e kuvendit                                                                                                                                          |

### **Shqyrtimi i pikës 1.**

#### **Diskutimet:**

**Kryesuesi**, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. Pyet nëse dikush ka ndonjë pyetje apo diskutim rreth procesverbalit? Nuk ka kërkuar fjalën askush.

#### **Vendimet:**

**Miratohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

**Afati për zbatim:**

### **Shqyrtimi i pikës 2.**

#### **Diskutimet:**

**Kryesuesi**, vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020-2022. Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën ja kaloi Osman Sadikaj.

**Osman Sadikaj**, Zyrtar Kryesor Financiar prezantoi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022.

**Kryesuesi**, hapi debatin dhe fjalën ja kaloi Haki Podrimaj pastaj me radhë.

**Haki Podrimaj**, propozoi disa projekte që nuk janë në KAB, Ndërtimi i Urës në Kaliqan, Eliminimi i lokaleve tek Stacioni i Autobusëve sipas Planit Urbanistik dhe Rruga Tranzit, të lirohet rruga e Istogut (nëse nuk është e propozuar).

**Lulzim Blakaj**, për këtë projekt janë propozu 1 milion e 800 mijë euro dhe është me titull tjetër.

**Enver Rugova**, për lokalet të Stacioni i Autobusëve është kërkesë që të eliminohen sepse ato janë të pa shfrytëzuara dhe janë në gjendje të keqe.

**Eliot Kukiqi**, popozoi projektin: Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në Gjurakoc (nga burimet e ndryshme të financimit).

**Ajshe Metaj**, propozoi projektet: "Ndërtimi i Kanalizimit në Lagjen Alushaj-Shushicë e Ulët", "Ndërtimi i Trotuarit Banje-Kashicë-Staradran" dhe "Ndërtimi i Rrugëve në Kamenicë, Lagjija Metaj dhe Lipaj".

**Ardita Idrizaj**, propozoi projektin: "Ndërtimi i Trotuarit Lubozhdë-Vrellë".

**Haki Podrimaj**, propozoi projektin: "Ndërtimi i Trotuarit nga Bajica, rruga e Banjës deri të varrezat e Carallukës.

**Zenel Shatri**, propozoi projektet: "Ndërtimi i Trotuarit nga Tomoci deri te Vaga" dhe "Ndërtimi i Kanalizimit në Lagjen e Bregut dhe Lagjen Imeraj-Tomoc".

**Hysni Maxharri**, projekti: "Ndërtimi i Rrugës unazore në Istog janë të planifikuara mjetet prej

burimeve tjera dhe 500 mijë euro i kemi nga burimet e sigurta.

**Eliot Kukiqi**, unë kam pyetje për një rrugë në Gjurakoc e cila ka qenë e para parë por nuk është ndërtuar? Por këtu është shënuar me emër të përgjithshëm.

**Osman Sadikaj**, ne shkojmë me emra të përgjithshëm dhe ju e keni mundësinë me cek cilën rrugë dhe ne e gjejmë emrin.

**Eliot Kukiqi**, ne e kemi propozu një rrugë por nuk është.

**Lulzim Blakaj**, qëllimi është të mos bëhen shumë tendera sepse kemi telashe pastaj. Për Gjurakoc është planifiku dhe është shpallur tenderi për Rrugën "Kurbini", Rruga e Bajram Haxhive, te Ferataj ndërsa Rruga "Xhafer Mehmetaj" nuk është përfshirë. Për këtë vit do të planifikohet edhe ndriçimi edhe trotuari. Për këtë qëllim është hjek kjo rrugë që të bëhet me ndriçim dhe me trotuar.

**Kryesuesi**, mbetet që në lidhje me këtë të mbahet edhe një debat me qytetarë. Fjalën ja kaloi Osman Sadikajt.

**Osman Sadikaj**, duhet të bëhet një dëgjim me qytetarë deri me 30.06.2019, me kohë jemi në rregull.

**Zenel Shatri**, unë kam vërejtje lidhur me dërgimin e materialeve sepse çdo herë po vijmë në momentin e fundit. Edhe për dëgjim që i bie të enjten një ditë para mbledhjes së kuvendit. Nuk e di se si mund ju të përgatiteni për mbledhje pastaj. Edhe aty do dalin propozime për projekte dhe mendoj është kohë e shkurtër që ato të përfshihen në material për kuvend.

**Kryesuesi**, propozimet do të shënohen dhe do të rekomandohen për mbledhjen e kuvendit. Këto propozime që dhatë shënohen në procerverbal dhe në rekomandime. Pastaj ato që dalin nga diskutimi publik që do të mbahet me 27.06.2019, ora 11:00, përpunohen dhe përcjellen për KK.

#### **Vendimet:**

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime të tjera, KPF njëzëri rekomandon: Shqyrtohet dhe miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2020-2022 dhe e njëjta i kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim me këto rekomandime për projekte që të përfshihen në KAB 2020-2022:

- 1) Ndërtimi i Urës në Kaliqan;
- 2) Eliminimi i lokaleve të Stacioni i Autobusëve sipas Planit urbanistik;
- 3) Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në Gjurakoc (nga burimet e ndryshme të financimit);
- 4) Ndërtimi i Kanalizimit në Lagjen Alushaj-Shushicë e Ulët;
- 5) Ndërtimi i Trotuarit Banjë-Kashicë-Staradran;
- 6) Ndërtimi i Rrugëve në Kamenicë, Lagjia Metaj dhe Lipaj;
- 7) Ndërtimi i Trotuarit Lubozhdë-Vrellë;
- 8) Ndërtimi i Trotuarit nga Bajica, rruga e Banjës deri të varrezat e Carallukës;
- 9) Ndërtimi i Trotuarit nga Tomoci deri tek Vaga dhe
- 10) Ndërtimi i Kanalizimit në Lagjen e Bregut dhe Lagjen Imeraj-Tomoc.

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 3.

#### Diskutimet:

**Kryesuesi**, vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik e Plotësim-ndryshimi Rregullores komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për subjektet afariste në komunën e Istogut. Keni mar materialin sot, keni rregulloren e vjetër duhet të plotësohet dhe ndryshohet. Kjo duhet të shpallet në diskutim publik, fjalën ja kaloi drejtorit.

**Lulzim Blakaj**, vetëm deshta sa për sqarim nuk bëhet fjalë për plotësim-ndryshim por është një rregullore e re. Do të thotë për rend ditë duhet të shkoj pikë e rendit ditës, rregullore e re. Është rregullore e rëndësishme dhe kërkoj të përcillet në diskutim publik dhe kërkoj të jepni kontribut. Tani nuk mund të kontribuni, është e juaja sa e shini të nevojshme këtë rregullore.

**Kryesuesi**, një gjë të qartësohet, kuvendi ka aprovu një rregullore të tillë. Ajo rregullore ekziston dhe është funksionale deri me tani. E nënshkruar nga kryesuesi i më hershëm dhe konsideroj duhet plotësim-ndryshim. Unë duhet të precizoj për rend ditë për kuvend. Unë po pyes për aspektin ligjor a duhet rregullore e re apo plotësim-ndryshim, si të precizohet pika e rendit të ditës?

**Lulzim Blakaj**, unë u sqarova por po theksoi se kur një rregullore ndryshohet më shumë se 40% duhet të shkojmë më rregullore të re. Me nxjerrjen e rregullores së re në dispozitat e fundit, paragrafin fundit theksohet decidivisht se më hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja e mëparshme.

**Kryesuesi**, tani u qartësua kemi të bëjmë më rregullore të re. A dëshiron dikush fjalën? Haki Podrimaj e ka kërku fjalën.

**Haki Podrimaj**, unë vetëm desha më plotësu, kjo rregullore me shumti atakon subjektet afariste, pasi shkon në diskutim publik kthehet prap dhe ne kemi pastaj çka të diskutojmë. Besoj se kemi me nxjerr një rregullore të mirë që ju duhet.

#### Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF njëzëri rekomandon: Shpallet në diskutim publik e Projekt-Rregullorja komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për subjektet afariste në komunën e Istogut dhe e njëjta i kalohet KK-së për shpallje në diskutim publik.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

### Shqyrtimi i pikës 4.

#### Diskutimet:

**Kryesuesi**, po vazhdojmë më pikën e katërt e rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për transparencë dhe Plani i punës së veprimit. Fjalën ja kaloi Drejtoreshës Edona Bujupi-Loxha.

**Edona Bujupi-Loxha**, përshendeti të pranishmit, jemi në pikën e rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për transparencë dhe Plani i punës së veprimit, që të dyja

janë obligim nga ministria. Ju kërkoj falje që ju kemi sjellë sot materialin por për shkak të takimit që kemi pasur me USAID-in projekti "Lego". Kanë insistuar të mbahet një takim për këtë dhe takimi ka qenë ditën e mërkurë dhe nuk kemi pasur mundësi më herët. Kjo është një projekt që do të shpallet në diskutim publik dhe është model thujasë i njëjtë në të gjitha komunat, vetëm dallojnë pak specifikat e komunës tonë.

**Ajshe Metaj**, mos të bëhet kjo shprehi që materialet të sjellën momentet e fundit. Se pasku një ditë para të na përcjellen ngase kur po vijmë këtu nuk po jemi të përgatitur. Këtë pikë e arsyetoj drejtoresha, mundoni me siguri pak më herët materialin.

**Kryesuesi**, materialet janë ardhur me kohë por nuk mund të përjashtohet mundësia e tillë. Pasi është fjala në diskutim publik të kalojmë këtë dhe do ta keni rastin të kontribuoni.

#### **Vendimet:**

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF njëzëri rekomandon: Shpallet në diskutim publik Projekt-Rregullorja komunale për transparencë dhe Plani i punës së veprimit për transparencë dhe të njëjtat i kalohen KK-së për shpallje në diskutim publik.

#### **Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

#### **Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

### **Shqyrtimi i pikës 5.**

#### **Diskutimet:**

**Kryesuesi**, po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimeve të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme të komunës me prona private. Për këtë pikë fjalën ja kaloi Zenel Shatrit.

**Zenel Shatri**, unë deri të kthehet drejtori kam pyetje, në Gjurakoc a punon ambullanta të dieleve? A ka mundësi me organizu me punu ngase qytetarët me ardh në Istog nuk është në rregull. Duhet të punojnë edhe të dielave në katër qendrat. Unë do të ngriti këtë pyetje edhe në kuvend.

**Mujë Osmanaj**, nuk punojnë por duhet të shikohet edhe kosto. Mund të shqyrtohet mundësia dhe të punojnë edhe të dielave.

**Jashar Blakaj**, përshendeti të pranishmit. Rruga prej Peja 3 që i thonë, Kërrninë, Belicë asfaltimi i rrugës, pjesa e jonë prej Belice kalon nëpër prona private. Janë bërë kërkesat në shërbimin pronësor-juridik që të bëhet këmbimi i pronës, procedurat janë zhvillu ligjërisht. Shërbimi pronësor-juridik me avokatin e komunës, me atë pronarë që ka pasur mundësi mu taku e kanë kryer elaboratin e shpronësimit apo këmbimit. Gjeodetët e kanë bërë raportin e kanë dorëzuar në shërbimin pronësor-juridik dhe janë hartuar këto propozim-vendime. Këto do të dërgohen dhe në ministrinë përkatëse për shqyrtim të ligjshmërsie dhe vlerësimi do të bëhet nga komisione në ministrinë përkatëse. Një propozim-vendim 01Nr.293/19 tjetër që dallon nga këto kemi për këmbimin e pronës në Veriq kalon nëpër prona të fermerëve. Një rrugë që është aty dhe kalon nëpër prona private dhe disa pronar kanë bërë kërkesë për të kalu nëpër këtë rrugë publike. Kjo për mbledhje të KK-së do të jetë me sllajde dhe sqarohet më mirë. Edhe në propozim-vendimi është bërë një gabim teknik duhet të hjeket fjala "asfaltimi".

**Kryesuesi**, Propozim-Vendimi 01Nr.293/2019, duhet të përmirësohet, të hjeket fjala "asfaltimi". Atëhere ne po votojmë lidhur më këto Propozim -Vendime. Duhet votim për secilin propozim-vendim.

**Vendimet:**

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime tjera, KPF njëzëri rekomandon: Shqyrtohet dhe miratohet: Propozim-Vendimi 01Nr.279/019, i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.280/019 i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.281/019, i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.282/019, i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.283/019, i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.284/019 i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.285/019 i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.286/019 i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.287/019 i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.288/019 i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.289/019 i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.290/019 i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.291/019 i datës:13.06.2019, Propozim-Vendimi 01Nr.292/019 i datës:13.06.2019 dhe Propozim-Vendimi 01Nr.293/019 i datës: 13.06.2019, të Kryetarit të komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme të komunës më prona private dhe i kalohen KK-së për shqyrtim dhe miratim.

**Personat përgjegjës për zbatim:**

Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:**

Deri në mbledhjen e kuvendit

**Kryesuesi**, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë dhe shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

**Mbledhja përfundoj :**

13:15